



**STRATEGJIA LOKALE E  
KOMUNËS SË  
KUMANOVËS  
PËR MROJTJE NGA HIV  
PËR PERIUDHËN 2016  
DERI MË 2020**



Komuna e Kumanovës. 2016



# **NUK KA ARSYETIM NËSE I SHUAJMË PROGRAMET MË TE CILAT SHPËTOHEN JETË**

Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e HOPS – Alternativë për jetë të shëndoshë Shkup dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Unionit Evropian.

Qëndrimet e paraqitura këtu janë qëndrime të organizatës dhe nuk i paraqesin ato të Fondit Global, as ekziston miratim ose autorizim i këtij materiali, të shprehur ose zbatuar nga Fondi Global.

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “Parandalimi i HIV dhe përdorimi i drogave ndërmjet qytetarëve të zonave kufitare”, i financuar nga Unioni Evropian përmes Instrumentit për ndihmë para aderimit; Komponenti 2: Programi për bashkëpunim ndër-kufitar. Strategjia dhe plani i veprimit janë propozim dokumente të përpiluara nga HOPS – Mundësi për jetë të shëndetshme Shkup dhe ende nuk janë zyrtarisht të miratuara nga Këshilli I vetëqeverisjes lokale.



## **STRATEGJIA LOKALE E KOMUNËS SË KUMANOVËS PËR MROJTJE NGA HIV PËR PERIUDHËN 2016 DERI MË 2020**

Planet e veprimit për vitet 2016 dhe 2017  
për zbatimin e Strategjisë lokale të komunës së Kumanovës  
për parandalimin e infeksionit nga HIV për periudhën e viteve  
2016 deri më 2020

**Botues**

Komuna e Kumanovës  
Reparti për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore

**Për botuesin**

Zoran Damjanovski, Kryetati i Komunës së Kumanovës

**Titulli**

Strategjia lokale e komunës së Kumanovës për parandalimin e infeksionit nga HIV për periudhën e viteve 2016 deri më 2020. Plani i veprimit për vitet 2016 dhe 2017 për zbatimin e Strategjisë lokale të komunës së Kumanovës për parandalimin e infeksionit nga HIV për periudhën e viteve 2016 deri më 2020.

**Korrekturë**

Vesna Kostoska

**Dizajni**

Zharko Stojanovic

**Shtyp**

Polyesterday

**E kuotoni këtë botim si më poshtë:**

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

616.98:578.828.7]-084(497.721)»2016/2020»

STRATEGJIA lokalë e Komunës së Kumanovës për mrojtje nga HIV për periudhën 2016 deri më 2020. - Shkup : HOPS - opsione për jetë të shëndoshë, 2016. - 24 str. : табели ; 30 см

Публикацијата е во рамки на проектот: «Parandalimi i HIV dhe përdorimi i drogave ndërmjet qytetarëve të zonave kufitare». - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4701-26-2

а) Превенција од ХИВ - Акциски планови - Куманово - 2016-2020  
COBISS.MK-ID 101889802

Në përpilimin e Strategjisë lokale dhe të Planeve të veprimit për parandalimin e HIV infeksionit në Komunën e Kumanovus, morën pjesë:

### **Grupi punues:**

Grupi punues:

Prim. Dr. Sunçica Josifova – specialit infektolog, reparti për sëmundje infektuese Kumanovë, Këshilltare në Komunën e Kumanovës

Dragica Vellkovska – arsimtare, Këshilltare në Komunën e Kumanovës

Dr. Jadranka Stamenkovska – Qendra e shëndetit publik – Kumanovë.

Jagoda Aleksievska – psikolog, Qendra për varësi Kumanovë

Stojna Millkoska – sociolog, Qendra për varësi Kumanovë

Natasha Trajkoski – koordinuese e programit për координатор за програма намалување на штети од употреба на дрога, Асоцијација за здрави животни стилови Пулс Куманово

Manuella Tasevska – punëtor social, Shoqata për stil të shëndetshëm të jetës Puls Kumanovë

Iva Mlladenovska – bashkëpunëtore profesioniste për shëndetësi, OO Kryqi i Kuq Kumanovë

Robert Jovanovski – punëtor në terren, Shoqata për stil të shëndetshëm të jetës Puls Kumanovë

Sasho Merxhanoski – Inter etnik Projekt Gostivar

### **Grupet punuese dhe udhëheqësit:**

Trupi koordinues për HIV/SIDA e

Adresimi i kryetarit së Komunës të Kumanovës

# Përmbajtja

SHKURTESAT	6
Hyrje	7
Karakteristikat demografike të Komunës së Kumanovës	9
Komuna e Kumanovës për mbrojtje nga infeksioni HIV/SIDA	9
Institucionet dhe organizatat të cilat zbatojnë ose mund të kontribuojnë për parandalimin dhe trajtimin e HIV infeksionit në Komunën e Kumanovës	11
Vizioni, misioni dhe vlerat	12
Fushat dhe qëllimet strategjike	13
Fusha strategjike 1: Parandalimi dhe rritja e ndërgjegjes për infeksionin HIV dhe rreziqet e ndërlidhura në popullatën lokale	13
Fusha e veprimit 1: Zhvillimi i ndërgjegjes te e tërë popullata që jeton në teritorin e Komunës së Kumanovës	13
Fusha e veprimit 2: Sensibilizimi i të punësuarve dhe të angazhuarve në institucionet që janë në kontakt me grupet/skomunitetet më të prekura nga HIV infeksioni (punëtorët shëndetësor, social, punëtorët në arsim, policia)	13
Fusha e veprimit 3: Sensibilizimi i gazetarëve dhe redaktorëve të mediave publike	13
Fusha strategjike 2: Parandalimi i HIV infeksionit tek grupet/komunitetet më të ndjeshme ndaj HIV infeksionit	13
Fusha e veprimit 1: Parandalimi i infektimit nga HIV te personat që injektojnë droga.	13
Fusha e veprimit 2: Parandalimi i infektimit nga HIV te punëtorët e seksit.	14
Fusha e veprimit 3: Parandalimi i infektimit nga HIV te meshkujt që bëjnë seks me meshkuj.	14
Fusha e veprimit 4: Parandalimi i infektimit nga HIV te rinia e moshës shkollore në shkollat fillore dhe të mesme.	14
Fusha e veprimit 5: Këshillimi dhe testimi vullnetar si masë kyçe për parandalimin dhe trajtimin e HIV infeksionit.	14
Fusha strategjike 3: Koordinimi, bashkëpunimi dhe mobilizimi i burimeve për zbatimin e aktiviteteve për mbrojtje nga HIV	14
Fusha e veprimit 1: Motivimi i të punësuarve në Komunën e Kumanovës për kyçe në aktivitetet për parandalimin e HIV infeksionit	15
Fusha e veprimit 2: Themelimi i koordinimit mes organizatave dhe institucioneve të cilat punojnë në mbrojtje nga HIV në Komunën e Kumanovës	15
Fusha e veprimit 3: Nxitja e aktiviteteve dhe projekteve për mobilizimin e burimeve për zbatimin e aktiviteteve nga Strategji	15

Fusha e veprimit 4: Sigurimi i ndihmës profesioniste dhe teknike për avancimin e kapaciteteve të personave që merren me mbrojtje nga HIV	15
Planet e veprimit	16
Fusha strategjike 1: Parandalimi dhe ngritja e ndërgjegjes për HIV infeksionin dhe rreziqet e ndërlidhura për popullatën lokale	16
1. Zhvillimi i ndërgjegjes të e tërë popullata që jeton në teritorin e Komunës së Kumanovës	16
2. Senzibilizimi i të punësuarve dhe të angazhuarve në institucionet që janë në kontakt me grupet/skomunitetet më të prekura nga HIV infeksioni (punëtorët shëndetësor, social, punëtorët në arsim, policia)	16
Fusha strategjike 2: Parandalimi i HIV infeksionit tek grupet/komunitetet më të ndjeshme ndaj HIV infeksionit	17
1.Parandalimi i infektimit nga HIV te personat që injektojnë droga	17
2. Parandalimi i infektimit nga HIV te punëtorët e seksit	17
3. Превенција на ХИВ-инфекција кај мажите кои имаат секс со мажи	17
4. Parandalimi i infektimit nga HIV te rinia e moshës shkollore në shkollat fillore dhe të mesme	18
Fusha strategjike 3: Koordinim dhe bashkëpunim	18
<b>SIGURIMI I MJETEVE DHE PARTNERITETEVE STRATEGJIKE</b>	<b>19</b>

# SHKURTESAT

PID	Personat që injektojnë drogë
PS	Punëtorët e seksit
MSM	Meshkuj që kanë seks me meshkuj
QSHP	Qendra e shëndetit publik
QPS	Qendra për punë sociale
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
Hiv	Virusi human i imunodeficiencës
KTV	Këshillim dhe testim vullnetar
PD	Përdoruesit e drogave
kARV	Terapi e kombinuar antiretrovirale
SSR	Shëndeti seksual dhe riprodhues



# 1. Hyrje

Sipas Programit Kombëtar për HIV dhe SIDA në Republikën e Maqedonisë në vitin 2015 numri i njerëzve në Maqedoni të cilët jetojnë me HIV mbetet i ulët, duke përfshirë edhe komunitetet më të prekura. Duke filluar nga 1987 deri në dhjetor 2015 janë regjistruar 274 raste të HIV dhe SIDA. Në shumicën e rasteve të regjistruarit kanë paraqitur se janë infektuar përmes modalitetit heteroseksual të transmetimit

Sipas Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Maqedonisë, rasti i parë të një pacienti të infektuar me HIV në Maqedoni është regjistruar në vitin 1987, dhe menjëherë pastaj edhe rasti i parë të një pacienti me SIDA. Deri në fund të vitit 2015 në Maqedoni janë regjistruar 236 persona që jetojnë me HIV dhe SIDA, nga të cilët 170 kanë qenë të infektuar me SIDA dhe 104 ishin vetëm HIV pozitiv. Deri në fund të vitit 2015, 80 njerëz kanë vdekur nga SIDA. Nga numri i përgjithshëm i rasteve të HIV dhe SIDA deri në fund të vitit 2015, shumica e personave me infeksion HIV dhe SIDA jetonin në Shkup. Në Komunën e Kumanovës qysh nga fillimi i epidemisë HIV në vend janë diagnostikuar 15 njerëz që jetojnë me HIV. Dominon popullata mashkullore. Shumica e pacientëve janë testuar pas rekomandimit të mjekut, kurse një pjesë e pacientëve janë testuar vullnetarisht për shkak të rrezikut të njohur për HIV infeksion.

Me analizimin e të dhënave epidemiologjike nga fillimi i epidemisë HIV në Republikën e Maqedonisë për periudhën 1987 - 2012 mund të marrim më shumë konkluzione. Merret përshtypja për dy faza të epidemisë HIV në vend. Faza e parë është përshkruar në periudhën nga 1987 deri në vitin 2004, kur kishim një total prej 55 personave të regjistruar me SIDA, dhe faza e dytë, e cila karakterizon periudhën e viteve 2005-2012, kur u regjistruan 88 të sëmurë nga SIDA. Faza e parë e epidemisë u karakterizua nga një mbizotërim të infeksionit HIV në popullatën heteroseksuale në grup-moshën 20-39 vjeç. Në këtë kohë, prej 55 personave të zbuluar që vuajnë nga SIDA, vdiqën 47 dmth 85.4% të pacientëve. Gjatë kësaj periudhe në vend nuk ishte në dispozicion trajtimi i kombinuar ARV, as që ishin në dispozicion shërbimet e këshillimit psiko-social e as KTV. Të gjithë pacientët ishin të zbuluar në fazën SIDA dhe në ambiente spitalore. Në periudhën 2005-2012, u ndje një rritje e rasteve të reja të zbuluara të HIV dhe SIDA. U regjistrua një total prej 99 njerëzve që jetojnë me HIV dhe SIDA, në fakt më shumë se gjysma (58.6%) nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara në vend. Analiza e të dhënave epidemiologjike nga kjo periudhë e epidemisë HIV në vend, tregon për rritjen e numrit të rasteve të reja me HIV për një periudhë shumë të shkurtër kohe. Karakteristikat demografike nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në të dyja periudhat, por ka ndryshim të rëndësishëm në mënyrën e transmetimit të infeksionit në periudhën 2005-2012, ku për 4.1 herë është rritur shkalla e infektimit me HIV në mesin e homoseksualëve në krahasim me periudhën nga 1987 deri në vitin 2004. Gjatë kësaj periudhe, norma e mortalitetit nga SIDA ishte ulur ndjeshëm nga norma e 85.4% të vdekjeve në periudhën 1987-2004, krahasuar me 23 persona të vdekur, 28.3% në periudhën 2005-2012.<sup>1</sup>

Bazuar në të dhënat epidemiologjike, Republika e Maqedonisë ende i takon grupit të të vendeve me një normë të ulët (prevalencës) të infeksionit HIV, ka progres të madh në uljen e vdekshmërisë nga infektimi me HIV dhe SIDA si meritë që në të madhe i atribuohet reagimit të kohshëm të institucioneve dhe organizatave të veçanta. Futja e vazhdueshme e kARV trajtimit, intensifikimi i KTV, si dhe përgjigjes më të organizuar kombëtare për të mbrojtur njerëzit nga infektimi me HIV fillon të zbatohet prej nëntorit

<sup>1</sup> Karakterizimi gjenetik klinik, epidemiologjik dhe molekular i HIV infeksionit në Republikën e Maqedonisë, M. Stevanoviq, 2014, faq. 25

të vitit 2004, në sajë të një projekti për luftë kundër SIDA, tuberkulozit dhe malaries, të financuar nga Fondi Global. Me aktivitetet e financuara nga Fondi Global menaxhon Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Maqedonisë, kurse zbatohen nga disa institucione shtetërore dhe organizata të shoqërisë civile. Fondi Global do të financojë veprimet për të mbrojtur popullatën nga infektimi me HIV deri në fund të vitit 2016, dhe që nga viti 2017 këto aktivitete duhet të financohen nga buxheti kombëtar, buxhetet e njësive të qeverisjes lokale dhe burimeve të tjera.

Me Ligjin për Shëndet Publik parashihen autorizime më të gjera të njësive të qeverisjes vendore në ruajtjen dhe promovimin e shëndetit. Qeveritë lokale kanë një detyrim për të krijuar këshilla për shëndetin publik që «studiojnë çështjet dhe politikat në fushën e shëndetit publik, përgatit mendime, iniciativa dhe/ose propozime për njësitë e qeverisjes vendore.» Për të ruajtur dhe për të promovuar shëndetin e popullatës në mënyrë efektive, me të njëjtin nen këmbëngulet në forcimin e bashkëpunimit mes ministrive përkatëse, qeverive lokale, biznesit dhe qytetarëve. Përgjegjësia për kujdesin shëndetësor të popullsisë u jipet njësive të qeverisjes lokale siç është përcaktuar me nenin 22, paragrafi 1, Akti 9 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Strategjia Kombëtare për Parandalimin e HIV-it 2012-2016 parashikon «përfshirjen e pushtetit lokal në krijimin e përgjigjes kombëtare për parandalimin nga infektimi me HIV.»<sup>2</sup>

Duke pasur parasysh mundësitë e favorshme për përfshirjen e pushtetit lokal në mbrojtjen e shëndetit publik dhe në veçanti nevojën për të mbrojtur popullatën lokale nga infektimi me HIV, komuna e Kumanovës vendosi të miratojë Strategjinë Lokale për parandalimin e infeksionit HIV në komunën e Kumanovës për periudhën nga viti 2016 deri më 2020. Për zbatimin e Strategjisë Lokale u hartua dhe një Plan veprimi për vitet 2016 dhe 2017.

## Karakteristikat demografike të Komunës së Kumanovës

Komuna e Kumanovës sipas ndarjes së re territoriale nga gushti 2004, është komuna më e madhe në Republikën e Maqedonisë. Ajo është e vendosur në pjesën veri-lindore të republikës në vet kryqëzimin e dy korridoreve 8 dhe 10.

Me pozitën e saj gjeostrategjike është një komunë me sfida të mëdha për zhvillimin në të gjitha fushat sidomos me fillimin e procesit të decentralizimit i cili filloi në korrik të vitit 2005.

Struktura e popullsisë në komunën e Kumanovës është heterogjene, dhe ate jo vetëm në qytet por edhe në zonat më rurale, ku ka një popullsi prej kombësive të ndryshme dhe grupeve etnike, strukturë të ndryshme arsimore, moshore dhe gjinore, me tradita të ndryshme, konfesionet dhe zakone, profesione të ndryshme dhe karakteristika të tjera.

Sipas regjistrimit të vitit 2002, në komunën e Kumanovës jetojnë një popullsi prej 103,205 personash dhe ate:

<sup>2</sup> Ministria e Shëndetësisë 2012: 29; Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 22/10; 136/11; 144/14; Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 5/02.

	Gjithsej	Maqedonas	Shqipëtar	Turq	Romë	Vllehë	Serb	Boshnjakë	Tjerë
	103 205	61 495	27 290	292	4256	0147	09035	20	670
%		59,58%	26,44%	0,28%	4,03%	0,14%	8,59%	0,02%	0,64%

## Komuna e Kumanovës për mbrojtje kundër infeksionit HIV

Komuna e Kumanovës me seriozitet të madh i shqyrton dhe analizon karakteristikat e Komunës për rreziqet e mundshme të infektimit me HIV dhe me përgjegjësi përfshihet në përpjekjet kombëtare për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë.

Dokumentet ekzistuese të miratuara nga Komuna e Kumanovës që kontribuojnë në mbrojtjen e popullsisë nga infektimi me HIV:

- Programi për mbrojtje të popullsisë nga sëmundjet infektive. Propozim ndryshim të programit, me këtë përmbajtje: «Edukimi i qytetarëve dhe ngritjen e vetëdijes në mesin e të rinjve për parandalim nga infektimi me HIV dhe përdorimit të drogës, si dhe qasje në shërbimet për grupet më të ndjeshme», që u miratua në seancën e Komunës së Kumanovës më 16.12.2015.

- Plani i Veprimit për parandalimin e HIV-it në mesin e të rinjve më në rrezik për vitin 2008. Së pari u miratua nga Këshilli i Komunës së Kumanovës. Ai u krijua nga HOPS, PULS dhe MHRN.

Pas fillimit të projektit Mirëmbajtja e prevalencës së ulët të HIV-it në RM dhe Zhvillim i vazhdueshëm, të mbështetur nga një grant nga Fondi Global për të luftuar HIV/SIDA, Tuberkulozit dhe Malaria, në 10 vitet e fundit në Komunën e Kumanovës zbatohen me sukses disa aktivitete për parandalimin e infektimit me HIV ndër grupet më në rrezik. Në vitet e fundit u ndërtuan më shumë kapacitete që janë të trajnuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të arsimuar për zbatimin e këtyre aktiviteteve në institucionet shëndetësore publike dhe në sektorin joqeveritar. Në territorin e Komunës së Kumanovës poashtu në vazhdueshmëri kryhen aktivitete të shumta për parandalimin e infeksionit HIV, të tilla si:

- Shkëmbimi i pajisjeve sterile injektuese për PD (OJQ PULS Kumanovë)
- Këshillim i besueshëm vullnetar dhe testim për HIV në mesin e PD, MSM, rinisë dhe popullatës së përgjithshme. (OJQ PULS Kumanovë)
- Klinikë Mobile për shëndetin seksual dhe riprodhues (OJQ PULS Kumanovë)
- Këshillimore për HIV/SIDA (Qendra e Shëndetit Publik Kumanovë)



# Institucionet dhe organizatat që zbatojnë ose kanë mundësitë kontribuojnë në parandalimin dhe trajtimin e HIV infeksionit në Komunën e Kumanovës

**ISHP «Klinika Universitare për sëmundje infektive dhe kushtet febrile»** - Shkup është i vetmi institucion në Maqedoni për testimin, trajtimin dhe kujdesin për njerëzit që jetojnë me HIV. Në kuadër të klinikës ekziston dhe këshillimore për HIV.<sup>3</sup>

**ISHP «Qendra e Shëndetit Publik» - Kumanovë**, kryen trajnime dhe ligjerime mbi infeksionin HIV, ka Këshilltoren për HIV, në të cilën bëhet këshillim dhe testim vullnetar dhe konfidencial për HIV.<sup>4</sup>, dhe ka laborator të akredituar dhe në terren për KTV.

**Qendra për varësi në Komunën e Kumanovës** nën administrimin e Spitalit të Përgjithshëm Kumanovë, ofron trajtimin me terapi zëvendësuese me metadon.

**Kryqi i Kuq Kumanovë** – bën edukime mocanike për parandalimin e HIV infeksionit.

**H.E.R.A. – Shoqata për edukim shëndetësor dhe hulumtime** për të ruajtur prevalencë të ulët të HIV-it dhe sigurim i mbrojtjes të plotë për njerëzit që jetojnë me HIV apo të prekur nga HIV mes popullatës së përgjithshme, veçanërisht në mesin e të rinjve dhe në mesin e grupeve të cënueshme. H.E.R.A. avokon për rritjen e ndërgjegjësimit për testim për HIV dhe për këtë arsye kryen fushata, trajnime dhe ofron këshillime falas vullnetar dhe konfidenciale për HIV në 11 qytete të Maqedonisë, në bashkëpunim me 13 shoqata lokale dhe 9 institucione shëndetësore.<sup>5</sup>

**Shoqata për stil të shëndetshëm të jetë PULS Kumanovë**, punon në drejtim të reduktimit të pasojave nga përdorimi i drogës, punë dhe edukim të PD, parandalimin parësor të HIV dhe hepatitit, bashkëpunim me OJQ-të tjera, qendrat shëndetësore dhe ato sociale. Në bashkëpunim me H.E.R.A., ekipi i programit të PULS në Kumanovë zbaton aktivitetet në klinikën celulare për shëndetin seksual dhe riprodhues në kuadër të projektit «Ruajtja e prevalencës së ulët të HIV-it në Maqedoni, të mbështetur nga Fondi Global për të luftuar HIV-in. Në kuadër të projektit të njëjtë, zbatohet edhe KTV vullnetare, në bashkëpunim me H.E.R.A. dhe Qendrën e Shëndetit Publik të Kumanovës.

3 KSIGF 2015.

4 QSHP 2015.

5 H.E.R.A. 2015.

# Vizioni, misioni dhe vlerat

## Vizioni

Komuna e Kumanovës, komuna në të cilën nuk ka diskriminim, e cila siguron qasje të barabartë në shërbimet sociale dhe shëndetësore, respekton dhe çmon aspektet e diversitetit, komunavë pa persona që vuajnë nga SIDA.

## Misioni

Mbrojtje e popullsisë lokale nga infektimi me HIV nëpërmjet edukimit formal dhe joformal, ngritjen e vetëdijes dhe informim të duhur për banorët në komunën e Kumanovës dhe arsimim të vazhdueshëm të profesionistëve të shëndetësisë me qëllim për të reduktuar stigmën dhe paragjykimet, parandalim, zbulim të hershëm, kujdes në kohë dhe mbështetje për njerëzit të infektuar me HIV.

## Vlerat

- Shëndet për të gjithë
- Qasje e barabartë në shërbimet shëndetësore dhe sociale
- Respektim i diversitetit
- Inkluzioni social
- Të drejta dhe liri të barabarta
- Dinjiteti njerëzor

# Fushat dhe qëllimet strategjike

## **Fusha strategjike 1: Parandalimi dhe ngritja e ndërgjegjës për HIV infesionin dhe rreziqet e ndërlidhura në popullaten lokale**

**Qëllimi kryesor:** Sigurim i informacioneve të sakta dhe lehtë të qasura për rrezikun e infektimit me HIV dhe për të reduktuar stigmën dhe paragjykimet si rezultat i informacionit të pamjaftueshëm në Kumanovë

**Fusha e veprimit 1:** Zhvillimi i ndërgjegjes te e tërë popullata që jeton në teritorin e Komunës së Kumanovës.

Sigurimi in informacionit dhe eksploatimi medial i rregullt në mediat lokale (TV, gazetata, radio stacionet, portalet)

**Fusha e veprimit 2:** Sensibilizimi i të punësuarve dhe të angazhuarve në institucionet që janë në kontakt me grupet/skomunitetet më të prekura nga HIV infeksioni (punëtorët shëndetësor, social, punëtorët në arsim, policia)

Arsimi i rregullt, kryesisht nga mjekët e familjes për infeksionit HIV me qëllim të identifikimit të kushteve që mund të lidhen me HIV, motivim për testim për HIV dhe sensibilizimin e tyre për të punuar me pacientët të cilët janë HIV të infektuar. Informim i përshtatshëm për edukatorët me qëllim të edukimit të vazhdueshëm në shkolla si një plotësues i domosdoshëm për edukim moshatar. Informim i policisë për mbrojtje në punën e tyre të përditshme por edhe motivimin e tyre për bashkëpunim me OJQ-të.

**Fusha e veprimit 3:** Sensibilizimi i gazetarëve dhe redaktorëve të mediave publike

Edukim për paraqitje të sakta për HIV infesionin, në mënyrë informative me brojtje të të dhënave personale dhe pa senzacionalizëm.

## **Fusha strategjike 2:Parandalimi i HIV infeksionet në grupet/komunitetet më të ndjeshme ndaj HIV infeksionit**

**Qëllimi kryesor:** Mbajtja e prevalencës së ulët të rasteve të reja të infetimit nga HIV në komunitetet më të cenueshme.

**Fusha e veprimit 1:** Parandalimi i HIV infeksionit te personat që injektojnë drogat.

Sigurim i vazhdimësisë në veprimet për të reduktuar rrezikun nga drogat të cilat tani po zbatuohen dhe me gjasa të mëdha kanë kontribuar në masë të madhe që HIV infeksioni të mos përhapet në mesin e përdoruesve të drogës. Republika e Maqedonisë nuk ka përdorues të drogës të gjallë që janë të infektuar me HIV.

**Fusha e veprimit 2:** Parandalimi i HIV infeksionit te punëtorët e seksit.

Bashkëpunimi i OJQ-ve nga komuna e Kumanovës me OJQ-të nga komunat e tjera që punojnë me këtë popullsi të synuar. Aktivitetet e bashkëpunimit do të sigurojnë ndërtimin e kapaciteteve të cilat në këtë çast Komuna e Kumanovës nuk i ka, bashkëpunimin me policinë. Duke pasur parasysh se kjo popullatë në Kumanovë është ende e fshehur dhe nuk punohet direkt me të në terren, zbatimi i edukimit për parandalimin e HIV-it do të jetë me dobi të veçantë në ruajtjen e numrit të ulët të infeksioneve me HIV në komunë.

**Fusha e veprimit 3:** Parandalimi i HIV infeksionit te meshkujt që kanë seks me meshkuj.

Bashkëpunimi i OJQ-ve nga komuna e Kumanovës me OJQ-ve nga komunat e tjera që punojnë me këtë popullsi të synuar. Aktivitetet e bashkëpunimit do të sigurojnë ndërtimin e kapaciteteve që në momentin Komuna e Kumanovës nuk i ka, organizim i komunitetit MSM do të jetë e dobishme për zbatimin e arsimit për të minimizuar rrezikun e infektimit me HIV në mesin e MSM. Arsimi moshatar, si dhe nxitja për testim të rregullt për HIV me qëllim të zbulimit të hershëm të infeksionit HIV dhe kujdesin e duhur për ata të infektuar me HIV duke filluar kARVT si një lidhje kryesore në procesin e parandalimit të përhapjes së HIV-it.

**Fusha e veprimit 4:** Parandalimi i infeksionit HIV te rinia në shkollat e mesme dhe fillore.

Futja e edukimit seksual në klasat e rregullta do të mundësojë shkatërrimin e tabuve primitive që lidhen me seksin dhe seksualitetin, do të mundëson informacionin e duhur për të rinjtë në bazë të njohurive shkencore. Edukimi sistematik i prindërve dhe mësuesve si dhe përfshirja e edukatorëve nga OJQ-të do të ofrojnë arsim të vazhdueshëm të përshtatshëm për moshën e nxënësve.

**Fusha e veprimit 5:** Testimi dhe këshillimi vullnetar si masë kyçe për parandalimin dhe trajtimin e HIV infeksionit.

Sigurim i vazhdimësisë të aktiviteteve për KVT si stacionare ashtu edhe në terren ka një rëndësi të madhe për parandalimin e përhapjes së infeksionit HIV. Nevoja për vendosjen e indikacionit për testimin e HIV-it duhet të afrohet edhe te çdo mjek në komunë me qëllim që të mos vijë tek një diagnozë të vonuar në asnjë pacient.

### **Fusha strategjike 3: Koordinimi, bashkëpunimi dhe mobilizimi i burimeve për zbatimin e aktiviteteve për mbrojtje na HIV**

**Qëllimi kryesor:** Krijimin dhe mbajtjen e komisionit lokal për parandalimin e infeksionit HIV në Kumanovë, i cili do të mbikëqyrë dhe koordinojë zbatimin e aktiviteteve, analizojë efektet e aktiviteteve të zbatuara dhe të njohë nevojën për aktivitete të reja.

Komisioni vendor për parandalimin e infeksionit HIV në komunën e Kumanovës do të përbëhet nga profesionistë, politikanë, përfaqësues të OJQ-ve dhe vendimmarrës në komunë, të cilët do të kenë dëshirë dhe ambicie për të krijuar kapacitete të reja në Komunë për të promovuar planin strategjik për parandalimin e infeksionit HIV, vlerësimin e aktiviteteve për parandalimin e HIV-it, në përpjekje për të gjetur fonde për zbatimin e tyre nga burime të ndryshme. Me rëndësi të veçantë do të ishte edhe përfshirja e sektorit të biznesit me një mbështetje financiare.



**Fusha e veprimit 1:** Motivimi i të punësuarve në Komunën e Kumanovës për kyqje në aktivitetet për parandalimin e HIV infeksionit

**Fusha e veprimit 2:** Themelimi i koordinimit mes organizatave dhe institucioneve të cilat punojnë në mbrojtje nga HIV në Komunën e Kumanovës.

**Fusha e veprimit 3:** Nxitja e aktiviteteve dhe projekteve për mobilizimin e burimeve për zbatimin e aktiviteteve nga Strategjia.

**Fusha e veprimit 4:** Sigurimi i ndihmës profesionale dhe teknike për avancimin e kapaciteteve të personave që merren me mbrojtje nga HIV.

## Planet e veprimit

# Fusha strategjike 1:

Parandalimi dhe ngritja e ndërgjegjës për HIV infezionin dhe rreziqet e ndërlidhura në popullatën lokale **Qëllimet kryesore të fushës strategjike**

Fusha e veprimit	Aktivitetet	Rezultatet	Treguesit e suksesit	Afati kohor	Zbatuesit	Partnerët
1. Zhvillimi i ndërgjegjës të e tërë popullata që jeton në territorin e Komunës së Kumanovës	Sigurimi i informacionit dhe ekspozimi medial i rregullt në mediat lokale (TV, gazetë, radio stacionet, portalet)	Nga jete mediale të organizuara, artikuj të botuar	Rejting	Një herë në muaj	QSHP, OIQ	Mediat lokale dhe rajonale, OIQ dhe QSHP
2. Senzibilizimi i të punësuarve dhe të angazhuarve në institucionet që janë në kontakt me grupet/skomunitetet më të prekura nga HIV infeksioni (punëtorët shëndetësor, social, punëtorët në arsim, policia)	Organizimi i seminareve për të edukuar mjekët primare të kujdesit, edukatorët në shkollat fillore dhe të mesme dhe punonjësit e SPB Kumanovë	Trajnimi i 100% të mjekëve të familjes, 50% të arsimtarëve në shkollat 8-9 vjeçare në klasat fillore dhe udhëheqësitë klasore në shkollat e mesme dhe përfaqësues nga radhët e ndryshme të policisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista e pjesëmarrësve</li> <li>• Fotografi</li> <li>• Prezantime</li> </ul>	Një herë në vit	QSHP, OIQ	QSHP, OIQ
3. Senzibilizimi i gazetarëve dhe redakttorëve të mediave publike	Organizimi i një punëtorie për të rritur bashkëpunimin me gazetarët	15 gazetarë të trajnuar nga media të ndryshme lokale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista e pjesëmarrësve</li> <li>• Fotografi</li> <li>• Prezantime</li> </ul>	Një herë në vit	QSHP, OIQ	Mediat lokale dhe rajonale, OIQ dhe QSHP

## Fusha strategjike 2:

Parandalimi i HIV infeksionet në grupet/komunitetet më të ndjeshme ndaj HIV infeksionit. **Qëllimet kryesore të fushës strategjike**

Fusha e veprimit	Aktivitetet	Rezultatet	Treguesit e suksesit	Afati kohor	Zbatuesit	Partnerët
1. Parandalimi i HIV infeksionit te personat që injektojnë drogat.  Mbjajtja e prevalencës së ulët të HIV në PID në Komunitetin Kumanovë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpërndarja e pajisjeve sterile injektuese</li> <li>• Shpërndarja e prezervativëve dhe lubrifikantë</li> <li>• Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promotivuese (broshura, postera)</li> <li>• Sigurimi i mjekimeve falas</li> <li>• Ofrimi i shërbimeve sociale falas</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i klientëve të pajisur me një paketë bazë të shërbimeve. Numri i klientëve të cilët janë trajtuar me shërbim mjekësor falas.</li> <li>• Numri i përdoruesve të cilëve ju është ofruar shërbim themelor social.</li> </ul>	Numri i gjithsejtë i personave që trajtohen në programet e shërrimit me terapi zëvendësuese.	Në vazhdimësi	OJQ	Qendra për varësi Kumanovë QSHP и OJQ
2. Prevençija на HIV-инфекција кај сексуалните работници/чки.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Градење капацитети во Општина Куманово за работење со оваа целна група</li> <li>• Промоција на ДДСТ за ХИВ и дистрибуција на кондоми</li> <li>• Гинеколошки прегледи</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Организирана работилница со партнерска организација</li> <li>• Број на спроведени советувања и тестирања за ХИВ</li> <li>• Број на клиенти кај кои се спроведени гинеколошки прегледи</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Листа на учесници</li> <li>• Фотографи</li> <li>• Презентации</li> <li>• Извештаи од спроведените тестирања</li> <li>• Извештаи од спроведени прегледи</li> </ul>	Në vazhdimësi	OJQ	OJQ, reparti për sëmundje infektive Kumanovë dhe QSHP
3. Prevençija на HIV-инфекција кај мажите кои имаат секс со мажи.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Градење капацитети во Општина Куманово за работење со оваа целна група</li> <li>• Промоција на ДДСТ за ХИВ</li> <li>• Дистрибуција на кондоми и лубриканти</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Организирана работилница со партнерска организација</li> <li>• Број на спроведени советувања и тестирања за ХИВ</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Листа на учесници, Фотографи, Презентации</li> <li>• Извештаи од спроведените тестирања</li> </ul>	Në vazhdimësi	OJQ	OJQ, reparti për sëmundje infektive Kumanovë dhe QSHP

## Fusha strategjike 3:

**Koordinimi, bashkëpunimi dhe mobilizimi i burimeve për zbatimin e aktiviteteve për mbrojtje na HIV. Qëllimet kryesore të fushës strategjike**

Fusha e veprimit	Aktivitetet	Rezultatet	Treguesit e suksesit	Afati kohor	Zbatuesit	Partnerët
4. Parandalimi i infeksionit HIV të rinia në shkollat e mesme dhe fillore.	Lobimi për futjen e edukimit seksual në shkollë; Organizim të edukimit të bashkëmoshatarëve mbi HIV dhe STD infeksionit në shkollë;	Numri i nxënësve që morën pjesë në edukimin mocanik dhe vlerësimin e njohurive të tyre;	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista e vlerësimit;</li> <li>• Lista e pjesëmarrësve</li> <li>• Fotografi</li> <li>• Prezantime</li> </ul>	Në vazhdimësi	OJQ, Uprben KpCT	Shkollat lokale, reparti për sëmundje infektive Kumanovë dhe OJQ

Fusha e veprimit	Aktivitetet	Rezultatet	Treguesit e suksesit	Afati kohor	Zbatuesit	Partnerët
Motivimi i punonjësve në Komunën e Kumanovës që të angazhohen në aktivitete për të parandaluar infeksionin me HIV	Krijimi i një organi koordinues për parandalimin e HIV-it, duke zhvilluar një qasje të koordinuar në komunë.	Koordinim i përmirësuar i aktiviteteve parandaluese në kuadër të komunës me të gjithë pjesëmarrësit në strategjinë, Organizim i takimeve për parandalimin	Aplikim për projete të reja dhe zbatimimi i tyre i përbashkët	Në vazhdimësi	OJQ	Gjithë pjesëmarrësit në strategjinë

# SIGURIMI I MJETEVE DHE PARTNERITETET STRATEGJIKE

Komisioni Vendor për HIV së bashku me koordinatorin lokal për HIV do të përgatisë një plan veprimi për të siguruar qëndrueshmëri financiare dhe mbështetjen e aktiviteteve në kuadër të strategjisë, e cila do të përfshijë angazhimet dhe veprimet e mëposhtme:

1. Lobimi për fonde nga buxheti kombëtar për parandalimin e HIV-it në komunitet
2. Inkurajimi i përgjegjësisë korporatave - sociale të sektorit të biznesit për të mbështetur aktivitetet parandaluese për HIV (konferenca të donatorëve, ngjarje bamirësie dhe forma të tjera të burimeve gjeneruese)
3. Fillimi i partneritetit publiko-privat për parandalimin e HIV
4. Zhvillimi i sipërmarrjeve sociale dhe ndërmarrjeve shoqërore
5. Përdorimi i fondeve të BE-së dhe fondacioneve ndërkombëtare si burime
6. Krijimi i partneriteteve dhe bashkëpunimit strategjik me organizatat të karakterit kombëtar dhe ndërkombëtar
7. Përgatitja e projekteve në bazë të thirrjeve të publikuara, si dhe projekteve për të cilat do të kërkohen donatorë.








XOPC  
ОПЦИИ ЗА ЗДРАВ ЖИВОТ СКОПЈЕ

**ME  
VENDIME  
KYÇE  
DERI NË  
BASHKËSI TË  
SHËNDETSHME**



*Edhe vendimi yt është kyç*

 The Global Fund

  
Ministry of Health  
of Republic of Macedonia

 Pulse

  
Multiethnic Project Goals

ГПëкpаhje civile dhe thirrje për vendimmarrësit për vazhdimin e projekteve dhe programeve të cilat sigurojnë kushte për parandalimin dhe përparimin e shëndetit të popullsisë